VENDIM
Nr.28, datë16.12.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese,
Gjergji Sauli	Anëtar	i “	“
Fehmi Abdiu	Anëtar	i “	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i “	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i “	“
Vitore Tusha	Anëtare	e “	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i “	“
Sokol Berberi	Anëtar	i “	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 26.6.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.11 Akti, që i përket:

KËRKUES: Viktor Nando, përfaqësuar nga avokat Sokol Puto, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Bashkia e qytetit Korçë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese të vendimeve nr.1096, datë 31.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr.180, datë 29.9.2005 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr.1412, datë 26.12.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f e 134/g të Kushtetutës, neni 6/1 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenet 27, 28, 30 e 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi; përfaqësuesin e kërkuesit që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi Viktor Nando ka pasur në pronësi një banesë në qytetin e Korçës, e cila është blerë nga babai i tij në vitin 1979 me kontratë të lidhur sipas legjislacionit të kohës. Kjo banesë është regjistruar në hipotekë.

Me vendimin nr.529, datë 28.10.1994, Komisioni i Kthimit e Kompensimit të Pronave, Korçë, bazuar në nenin 10 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, e kalon të drejtën e pronësisë së banesës së përmendur më sipër, nga kërkuesi te ish-pronari i saj. Kërkuesi, sipas këtij vendimi, përfiton masën e shpërblimit me vleftën 308.000 lekë, në formë kompensimi.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.12, datë 21.3.2000 ka shfuqizuar pjesërisht nenin 10 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", si të papajtueshëm me Kushtetutën, duke arsyetuar, ndër të tjera, se “Rregulli për masën e shpërblimit, sipas nenit 10 paragrafi i I-rë (çmimi në kohën e blerjes i konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, kur ky indeksim do të llogaritet sipas nenit 27 të ligjit në momentin e hyrjes në fuqi të tij), vjen në kundërshtim me parimin e barazisë dhe, pikërisht për këtë shkak, kjo pjesë e nenit 10 duhet të shfuqizohet si antikushtetuese. Aq sa është e drejtë dhe kushtetuese kthimi i pronave ish-pronarëve, po aq e drejtë dhe kushtetuese është sigurimi nga shteti i një shpërblimi të drejtë e të plotë të personave të tretë, duke marrë për bazë çmimin e tregut, d.m.th. vlerën reale që ka ndërtesa në momentin e dorëzimit tek ish-pronari”.

Në vitin 2005, kërkuesi bën padi kundër bashkisë Korçë, me objekt: Detyrimin e bashkisë Korçë

për të paguar vlerën e plotë reale të banesës që i ka marrë kërkuesit në favor të palëve të treta, pagimin e shpenzimeve të kryera në këtë banesë, mbajtjen e banesës deri në momentin e pagimit të plotë të detyrimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.1096, datë 31.5.2005, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.180, datë 29.9.2005, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1412, datë 26.12.2006, ka vendosur mospranimin e rekursit për mungesë shkaqesh, sipas parashikimeve të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

Kërkuesi pretendon se vendimet e mësipërme të tri gjykatave të juridiksionit të zakonshëm janë rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor, duke dhënë këto shkaqe:

- Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin e pushimit, cenon të drejtën e aksesit në gjykatë. Shprehja në vendimin e gjykatës se "…padia e ngritur nga paditësi nuk mund të ngrihet, aq më shumë kundër bashkisë" është e pabazuar në ligj. Vendimi i Komisionit të Kthimit të Pronave parashikonte se bashkia Korçë ishte autoriteti përgjegjës për pagimin e detyrimit financiar për kompensimin e vlerës së banesës. Vendimi për pushimin e gjykimit nga gjykata e apelit është një konkluzion i gabuar për shkak të interpretimit të gabuar të ligjit.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka rrëzuar pretendimin e kërkuesit për kërkimin e shpërblimit real për shkak të heqjes së të drejtës së pronësisë, me arsyetimin se shfuqizimi i nenit 10 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" është bërë nga Gjykata Kushtetuese në një kohë të mëvonshme nga data e marrjes së vendimit nr.529 të Komisionit dhe, për këtë arsye, nuk ka fuqi prapavepruese. Ky është një interpretim i gabuar i ligjit nga gjykata e faktit.

- Vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit, është i padrejtë dhe i ka mohuar të drejtën e aksesit në gjykatë.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar kërkoi rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar:

- Pretendimet e kërkuesit janë të pambështetura në ligj dhe në një shkak ligjor pasi në asnjë shkallë të gjykimit nuk janë shkelur të drejtat për një proces të rregullt ligjor.

- Gjatë gjykimit janë respektuar elementet e procesit të rregullt, si parimi i barazisë së palëve dhe zhvillimi i seancës me dyer të hapura.

- Pavarësisht faktit se Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.12 të vitit 2000, ka shfuqizuar pjesërisht nenin 10 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", dhënia e shpërblimit është bazuar në një dispozitë, e cila ka qenë në fuqi në kohën kur është dhënë shpërblimi. Kërkuesi nuk mund të përdorë si referencë ligjore një akt, i cili nuk ka fuqi prapavepruese dhe si rrjedhojë, nuk i shtrin efektet në marrëdhëniet juridike të lindura dhe të rregulluara më parë.

II

A. Lidhur me pretendimin se vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë

Kërkuesi pretendon se Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin e pushimit, cenon të drejtën e aksesit në gjykatë. Përfundimi në vendimin e gjykatës se "…padia e ngritur nga paditësi nuk mund të ngrihet, aq më shumë kundër bashkisë" është i pabazuar në ligj. Vendimi i Komisionit të Kthimit të Pronave parashikonte se bashkia Korçë ishte autoriteti përgjegjës për pagimin e detyrimit financiar për kompensimin e vlerës së banesës. Vendimi për pushimin e gjykimit nga gjykata e apelit është një konkluzion i gabuar për shkak të interpretimit të gabuar të ligjit.

Gjykata ripërsërit qëndrimin se mohimi i të drejtës së aksesit, d.m.th. i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare nga ajo lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.8, datë 13.3.2008, nr.7, datë 11.3.2008, nr.10, datë 11.5.2006).*

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ i siguron çdokujt të drejtën për të pretenduar të drejtat dhe detyrimet civile para një gjykate ose tribunali. Në këtë kuptim ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të filluar një proces para gjykatave për çështje civile, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit

në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk ka karakter absolut; ajo mund të ketë kufizime, por ato nuk duhet të kufizojnë hapësirën e aksesit për individin në një mënyrë të tillë sa e drejta të preket në thelbin e saj (*Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere, vendim i 23 qershor 1981; Sporrong dhe Lönnroth, vendim i 23 shtator 1982*).

Në çështjen në shqyrtim, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.180, datë 29.9.2005, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Në vendimin e saj, gjykata, ndër të tjera, shprehet se "… padia e ngritur nga paditësi nuk mund të ngrihet, aq më shumë kundër bashkisë Korçë, ...". Me këtë arsyetim, jo të plotë dhe të dykuptimshëm, gjykata e apelit ka vënë në diskutim të drejtën e kërkuesit për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje për themelin e pretendimit të tij dhe ka lënë të nënkuptohet që ai nuk ka një bazë ligjore ku mund ta mbështesë padinë e tij.

Gjykata e vlerëson të lidhur me të drejtën e aksesit parimin e deklaruar nga neni 1 i Kodit të Procedurës Civle (KPC): "Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë.".

Në bazë të këtij parimi, gjykata duhet të kërkojë gjithmonë brenda rendit juridik të shtetit shqiptar normën që rregullon një rast konkret. Ajo duhet të mbështetet në një autoritet që ka forcën e ligjit dhe që zgjidh mosmarrëveshjen konkrete. Në rast se një normë e tillë nuk ekziston, ajo duhet të kërkojë edhe norma të tjera që rregullojnë rastet analoge. Gjykata, për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, ka detyrën funksionale për të kryer interpretime të ndryshme në lidhje me kuptimin e normave, me kërkimin e normave që rregullojnë rastet analoge apo me identifikimin e parimeve të përgjithshme dhe të jurisprudencës kushtetuese.

Gjykata çmon se, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Apelit Korçë nuk ka respektuar detyrimet e evidentuara më sipër, që rrjedhin nga parimi i parashikuar në nenin 1 të Kodit të Procedurës Civile dhe nga e drejta e kushtetuese për t'iu drejtuar gjykatës. Ajo është mjaftuar duke u shprehur se padia e kërkuesit nuk mund të ngrihet ..., duke i cenuar këtij të fundit të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të marrë një përgjigje nga gjykata për themelin e pretendimit të tij.

Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi për cenimin e të drejtës së akcesit në gjykatë nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin e pushimit, është i mbështetur.

Gjykata çmon se vendimi nr.1412, datë 26.12.2006 i Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në të cilin është vendosur mospranimi i rekursit që kundërshtonte vendimin e mësipërm të Gjykatës së Apelit, për rrjedhojë duhet të shfuqizohet.

Lidhur me pretendimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë përmban një interpretim të gabuar të ligjit.

Kërkuesi pretendon se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë përmban një interpretim të gabuar të ligjit. Sipas kërkuesit, gjykata e faktit duhej të zbatonte në mënyrë të drejtpërdrejtë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.12 të vitit 2000, i cili ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe ka fuqi prapavepruese ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit të shfuqizuar.

B. Lidhur me interpretimin e ligjit nga gjykatat, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) është shprehur edhe më parë se interpretimi i dispozitave ligjore për shkakun juridik dhe objektin e padive që duhen ngritur për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, si dhe vlerësimi juridik i rrethanave dhe provave të parashtruara nga palët është në kompetencën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Kjo Gjykatë nuk vlerëson nëse interpretimi i kuadrit ligjor në fuqi nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është i drejtë nga pikëpamja ligjore, por nëse interpretimi sjell si pasojë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, bazuar në nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.8, datë 13.3.2008; nr.6, datë 15.4.2005; nr.36, datë 19.12.2003*).

Gjykata rithekson se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 7.2.2001*).

Në çështjen në shqyrtim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, në vendimin e saj, shprehet se *"...vendimi nr.12, datë 21.3.2000 i Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar paragrafin e parë të nenit 10 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve" nuk ka fuqi*

prapavepruese. Kjo nënkupton faktin se ky vendim, i cili ka fuqi erga omnes nuk i shtrin efektet për marrëdhënie juridike të lindura dhe rregulluara më parë. "Pra, gjykata e faktit nuk ka vënë në diskutim fuqinë detyruese të përgjithshme të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.".

Gjykata, bazuar në standardet e evidentuara më sipër, çmon se nuk është në kompetencën e saj të vlerësojë nëse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka identifikuar dhe ka interpretuar drejt ligjin e zbatueshëm dhe veprimin e ligjit në kohë në çështjen konkrete, përderisa kjo Gjykatë nuk konstaton cenimin e ndonjë aspekti të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Për sa më sipër, Gjykata nuk e gjen të mbështetur pretendimin për cenim të procesit të rregullt ligjor, për shkak të interpretimit të gabuar të ligjit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.180, datë 29.9.2005 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të vendimit nr.1412, datë 26.12.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Korçë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi